



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 32 / Prot.  
7

Tiranë, më 12/5/2015

REKOMANDIM

Nr. 20, datë 12/5/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit, Banka "**Societe Generale Albania**" sh.a,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.05, datë 21.01.2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u realizua hetimi administrativ pranë kontrolluesit, Banka "**Societe Generale Albania**" sh.a Tiranë, me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Kontrolluesi "**Societe Generale Albania**" sh.a. Tiranë, në kuptim të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është kontrollues, "*Për Bankën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 "*Për Bankat në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar si edhe në të gjithë aktet nënligjore që përbëjnë kuadrin rregullativ në fushën bankare. Kontrolluesi, ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh bankare për individë dhe biznese, të tilla si, llogari rrjedhëse, depozita me afat, financime dhe kredi, internet banking, karta krediti, transfertat bankare etj. Gjatë kësaj marrëdhënie të krijuar kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale të individëve (klientë), subjekte të të dhënave personale. Në kuadër të veprimtarisë së tij, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale kryesisht për kategoritë e subjekteve të të dhënave, *klientë, punonjës.*

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9887, dt. 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në procesverbalin e kontrollit, konstatoi se:

- ✚ Kontrolluesi, "**Societe Generale Albania**" sh.a., nuk ka kryer përditësimin e Formularit të Njoftimit pranë autoritetit të Komisionerit, me ndryshimet që kanë ndodhur gjatë përpunimit të të dhënave përsa i përket deklaramit, si më poshtë vijon:

a) Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen: nuk janë deklaruar dhe kategoritë e tjera të të dhënave personale të cilat konstatuam se përpunohen nga kontrolluesi, *si të dhënat mbi statusin civil, statusin e punësimit, nr. fax/e-mail, mbi pjesëtarët e familjes bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët, mbi punësimet e mëparshme, çertifikata pronësie, të dhënat e pasaportës dhe të kartës së identitetit, të dhëna për garantorët.*

b) Të dhënat sensitive: nuk është deklaruar që përpunohen të dhëna sensitive për mendimet politike. Gjithashtu, nuk është deklaruar qëllimi i përpunimit për të dhënë sensitive “mendimi politik” i cili, nuk është përfshirë në njoftimet e mëparshme.

c) Transferimin e të dhënave personale në drejtim të SHBA-ve: në kuadër të zbatimit të ligjit FATCA, u konstatua se kontrolluesi ka marrë masat e brendshme për të realizuar këtë transferim por, që ende nuk ka njoftuar lidhur me të.

*Neni 21/1, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.*

d) Përhapjen e të dhënave: kontrolluesi duhet të deklarojë marrësit e të dhënave personale, te të cilët në zbatim të kontratave të bashkëpunimit për shërbime të ndryshme që ky kontrollues ka lidhur me këta marrës, përhap të dhëna personale, si dhe të plotësohet qëllimi i përhapjes apo transmetimit. *(SHRSF, Tatim Taksa, Instituti Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, Zyra e Punësimit etj).*

✦ Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, dhe ofruesi i shërbimit (“Deloitte Albania Sh.p.k.”) me cilësinë e përpunuesit, në kontratën e auditimit të lidhur midis tyre, në kreun XIII, “Mbrotjtja e të Dhënave Personale”, artikulli 26, shprehet për masat teknike, organizative dhe personale, që ky përpunues do të sigurojë, por kjo mbetet në një kuadër formal, i padetruajuar në masat konkrete.

✦ Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, dhe ofruesi i shërbimit (“Deloitte Albania Sh.p.k.”), me cilësinë e përpunuesit, në kontratën e auditimit të lidhur midis tyre, në kreun XIII, “Mbrotjtja e të Dhënave Personale”, artikulli 27, dalin nga qëllimi fillestar (ai i auditimit), dhe përpunuesi konsideron, si marrje pëlqimi nga kontrolluesi, përdorimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave personale, “klientë” të kontrolluesit, për qëllime marketingu duke favorizuar përpunuesin-ofrues shërbimi (“Deloitte Albania Sh.p.k.”), kur në deklaratën standart të pëlqimit, që kontrolluesi ka finalizuar me klientin, dhe saktësisht, paragrafi 5, thuhet: “..vetëm dhe në funksion të marrëdhënies kontraktuale me Bankën”; gjithashtu klienti informohet se: “ shkëmbimi i informacionit do të jetë me Bankën e Shqipërisë për Regjistrin e Kredive”.

✦ Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, dhe ofruesi i shërbimit, Shoqëria e Sigurimeve, “Sigal Unica Group Austria, sh.a.”, nuk kanë parashikuar në kontratën e sigurimit të punonjësve të Policëmbajtësve me Sigurim Shëndetësor, sipas opsionit, “Standart i Reduktuar”, asnjë klauzolë, për mbrotjtjen e të dhënave personale të punonjësve, dhe

sidomos, kur është fjala për të dhëna sensitive, që Shoqëria e Sigurimeve, “Sigal Unica Group Austria, sh.a.”, i mbledh në rastet e rimbursimit të shpenzimeve mjekësore; kjo, pasi kontrolluesi mbetet pala përfaqësuese ligjore - kontraktuale për punëmarrësit e tij.

- ✦ Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, merr pëlqimin nga klientët e tij, në fazën fillestare, por dhe ky deklaram, nuk është ideuar në format alternative, dhe si i tillë “detyron” klientin, të mos ketë të drejtën e përzgjedhjes, se për cilat shërbime operacionale bankare të kontrolluesit, ai do të jepte pëlqimin; gjithashtu në transaksionet që ky kontrollues kryen, nuk ka një formë të informimit për mbrojtjen e të dhënave personale; p.sh.:Formulari i Urdhërit të Transfertës, urdhëruesi-klienti, bie dakord me një sërë deklaratash, por nuk ka deklarata pëlqimi të integruar, për përpunimin e të dhënave personale.
- ✦ Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, pasi mbledh të dhënat fillestare, për të gjithë klientët, kreditorët, ata që aplikojnë për overdraftin, për transferata etj, në informacionin standart për Kredikërkuesin, gjithashtu, i mbledh klientit të dhëna sensitive sipas rubrikës “bindjet politike” të tij, apo dhe të ndonjë anëtari të familjes, dhe jo vetëm kaq, por nëse përgjigja nga ana e klientit konsiston në alternativën “po”, i kërkohet atij, që “të shpjegojë me hollësi”. Kjo e dhënë sensitive, e mbledhur nga kontrolluesi, është e tepërt, si për klientin ashtu dhe për anëtarët e familjes; është i tepërt gjithashtu, opsioni “të shpjegojë me hollësi”, pasi është në kundërshtim me ligjin, edhe pse nuk është deklaruar në Formularin e Njoftimit.

Në lidhje me këto konstatime kontrolluesi ka paraqitur pretendimet përkatëse nëpërmjet shkresave nr. 1030 prot, datë 06.03.2015, referuar edhe në seancën dëgjimore të datës 25.03.2015. Seanca dëgjimore është realizuar nga Zyra e Komisionerit në zbatim të neneve 93-96 të ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Kontrolluesi, “Societe Generale Albania, sh.a”, ka paraqitur pretendimet e mëposhtme:

- Për sa i përket pikës së parë të shkeljes, kontrolluesi pretendon:  
“Informojmë se do i deklarojmë këto të dhëna në vijimësi.”, por, ende në Regjistrin e Njoftimeve pranë Zyrës së Komisionerit, rezulton se përditësimi nuk është realizuar. Sa më sipër, sa i përket detyrimit për njoftim dhe në vazhdimësi përditësimit të tij (neni 21, 22 i ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar) Zyra e Komisionerit vlerëson se është një nga detyrimet bazë që ka çdo kontrollues dhe si i tillë ka një pozicion të rëndësishëm në raport me detyrimet e tjera që parashikon ligji. Detyrimi për njoftim është në funksion të ushtrimit sa më të plotë dhe të saktë të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit dhe me të drejtat e subjekteve të të dhënave, pasi siguron informacionin e nevojshëm lidhur me kontrolluesit që operojnë në Shqipëri, fushat e veprimtarisë, kategoritë e të dhënave personale dhe sensitive që përpunohen, qëllimet e përpunimit, etj.

- Për sa i përket pikës së dytë dhe të tretë të shkeljes, kontrolluesi pretendon:  
“Lidhur me këtë konstatim sqarojmë se neni 26 nuk ka në fokus të dhënat personale të klienteve, por të dhënat e Bankës që akumulohen si rezultat i auditimit që ushtron “Deloitte Albania shpk” dhe po t’i referoheni nenit 1 - objekti i

kontrates, qëllimi i shërbimit është auditimi i pasqyrave financiare etj.(për më shumë lexoni neni 1 - objekti i kontrates).

Zyra e Komisionerit sqaron se, objekti i kontratës (neni 1) parashikohet vetëm dhe vetëm për pasqyrat financiare, ndërsa neni 26, në tërësinë e tij, shprehet për të dhënat personale të subjekteve, dhe theksohet “mbrojtja” e tyre, ku padyshim dhe nëpunësit e saj janë subjekte të të dhënave, qofshin ata në cilësinë e nëpunësve, qofshin ata në cilësinë e klientit; gjithashtu informacionet personale rreth përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve, sikundër kërkohet nga rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave etj; dhe këto dy kategori “nëpunës” dhe “persona të autorizuar”, nuk rezultojnë të jenë informuar, në lidhje me të dhënat që i jepen përpunuesit, si palë e tretë.

*“Lidhur me këtë konstatim sqarojmë se referuar kontratës, neni 27 ka të bëjë me të dhënat e punonjësve dhe jo me të dhënat e klienteve. Në të gjithë paragrafin e kontratës nuk ka asnjë referencë të të dhënave të klientëve por specifikohet qartë kush janë subjekt i këtij parashikimi.”*

Zyra e Komisionerit sqaron se, pëlqimin për përpunimin e të dhënave të punonjësve, e japin vetë punonjësit, dhe jo banka, e cila realizon një dhënie pëlqimi “në tërësi” tek të tretët, si një proces i paparashikuar në ligj. Nuk informohen subjektet e të dhënave për qëllimin e përpunimit të të dhënave duke mos i ofruar mundësinë që pëlqimi të jetë opsional dhe i ndarë nga pëlqimi për nënshkrimin e kontratës.

- Për sa i përket pikës së katërt të shkeljes, kontrolluesi pretendon:

*“Referuar përmbajtjes së kontratës dhe pikërisht objektit të saj, marrëdhënia kontraktuale midis SIGAL dhe SGAL është lëshimi i një police globale sigurimi, ku SGAL i ofron punonjësve të saj mundësinë për një kontroll mjekësor të rimbursueshëm nëpërmjet paketës së SIGAL dhe në këtë rast rregullohet marrëdhënia e Policës, pagesat e primit etj, por nuk ka në fokus trajtimin e të dhënave sensitive, pasi kjo është një marrëdhënie direkte e punonjësit me SIGAL. Në leximin e Neneve të kontratës nuk ka parashikime që Banka do të marrë trajtimin e dosjes së analizave të punonjësit.”*

Zyra e Komisionerit sqaron se, palët dhe gjeneralitetet e tyre në këtë kontratë, janë : Shoqëria e Sigurimeve Sigal Unica Group Austria dhe Banka Societe Generale Albania, sh.a. Kontrolluesi si palë përfaqësuese e punonjësve të saj (ashtu si dhe jep pëlqimin në kontratat e tjera në emër të tyre) të parashikojë masa detyruese me të tretët për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve, pasi në pyetje janë një gamë e gjërë të dhënash, dhe kryesisht ato sensitive.

Për sa i përket pikës pesë dhe gjashtë të shkeljeve të konstatuara, kontrolluesi pretendon:

*“Deklarata e pëlqimit është konceptuar mbi bazën e marrëdhënies së biznesit bankë-klient dhe vlen për të gjitha produktet bankare dhe për të gjithë jetëgjatësinë e marrëdhënies me klientin sic mund të verifikohet lehtë nga përmbajtja e deklaratës. Kjo është edhe arsyeja pse nuk ka deklarata pëlqimi të integruar në formularët e transaksioneve si në rastin e urdhër-transferit. Sidoqoftë, mbetemi në pritje të udhëzimeve më konkrete nga ana juaj lidhur me këtë pikë”.*

Zyra e Komisionerit sqaron se, klienti si subjekt i të dhënave ka të drejtë të përzgjedhë se cilat, operacione bankare do të aplikojë; preket parimi i mjaftueshmërisë, të të dhënave, duke marrë

gjithë gamën e të dhënave të subjekteve, qoftë edhe për një overdraft, apo një kredi konsumatore afatshkurtër, duke menduar për jetëgjatësinë e marrëdhënies, si një politikë e bankës kjo dhe jo e klientit.

*“Në formularin e aplikimit për kredi, në informacionin standard për kredikërkuuesin, sqarohet se: Kontrolluesi nuk mbledh të dhëna sensitive mbi bindjet politike të klientit apo ndonjë anëtar të familjes së tij.*

*Sic shihet edhe në formular informacioni i kërkuar lidhet me pjesëmarrjen në organizata politike, informacion ky i marrë në kuadër të politikave të njohjes së klientit në mënyrë që Banka të ushtrojë vigjilencën e duhur në përputhje me profilin e riskut të klientit në zbatim të kërkesave të ligjit “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.*

Zyra e Komisionerit sqaron se, kjo kategori të dhënash, konceptuar në formën e pyetjes, shprehimisht sipas formularit: “Jeni i/e aktivizuar në ndonjë organizatë politike? dhe: Nëse po, shpjegoni hollësisht.”, na saktëson se bëhet fjalë për organizatë politike dhe jo terroriste, por duhet kuptuar se, çdo përpunim të dhënash, edhe pse është detyrim ligjor duhet deklaruar në formularin e njoftimit, sipas kategorive përkatëse.

Faktet e mësipërme, përbëjnë shkelje administrative të parashikuar përkatësisht, nga nenet 21&22, neni 5-7, neni 18, neni 27 të ligjit.

Për shkeljet e konstatuara, kontrolluesi “Societe Generale Albania” sh.a., ende nuk ka reaguar për mangësitë e konstatuara në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore.

*Zyra e Komisionerit e vlerëson, si mjaft të rëndësishëm, procesin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit në sektorin bankar. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë. Problematikat i janë referuar praktikës së deritanishme në zbatim të ushtrimit të funksionit monitorues dhe mbikëqyrës së Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit, mangësive të konstatuara gjatë kontrolleve administrative të ushtruara në secilin kontrollues bankar dhe duhen patur parasysh nga kontrolluesit në ushtrimin e aktivitetit.*

Në këtë kuadër, kontrolluesi “Societe Generale Albania” sh.a., duhet të ketë parasysh në vijimësi, respektimin e parashikimeve të nenit 20 të ligjit. Në marrëdhëniet/marrëveshjet që krijon me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të sanksionohen rregulla mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave. Plotësimi i këtij detyrimi është mjaft i rëndësishëm pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër;

Në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura dhe konstatimeve të realizuara gjatë hetimeve administrative në kontrolluesit që ushtrojnë veprimtari në sektorin bankar,

## REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5 pika l/b, nenit 6/1/a dhe nenit 18 ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi "Societe Generale Albania" sh.a., të ketë parasysh mjaftueshmërinë e të dhënave, të marrë pëlqimin mbi të dhënat sensitive që përpunohen, pasi të ketë informuar në mënyrë të qartë klientët.
  - Të tregohet kujdes që në kontratat e shërbimit për produktet bankare, të informohen subjektet e të dhënave për qëllimin e përpunimit të të dhënave në kuadër të marketingut dhe promocionit të produkteve bankare, duke i ofruar mundësinë që pëlqimi në këtë rast, të jetë opsional dhe i ndarë nga pëlqimi për nënshkrimin e kontratës. Kjo përfshin edhe dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të tjera jashtë qëllimit fillestar të nënshkrimit të kontratës.
2. Në zbatim të nenit 18, të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi "Societe Generale Albania" sh.a., të informojë klientët, apo nëpunësit, për sa i përket përpunuesit/ve, që kanë akses në të dhënat e tyre, qëllimin/et e aksesimit të tyre, mbi të dhënat e klientëve të "Societe Generale Albania" sh.a. Në çdo format që sanksionon marrëdhënien e kontrolluesit me subjektet e të dhënave personale (klientin, punonjësin) të parashikohet një dispozitë për informimin e tyre mbi fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave;
  - Në faqen e internetit të kontrolluesit, të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë", dhe të përditësohen të dhënat me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
3. Në zbatim të nenit 20 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në marrëdhëniet/marrëveshjet që Banka krijon me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të tregohet kujdes në sanksionimin e rregullave mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.
4. Në zbatim të neneve 21, 22 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi "Societe Generale Albania" sh.a., të realizojë përditësimin e Formularit të Njoftimit sipas pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi dhe procesverbalit të kontrollit administrativ. Kontrolluesi të tregojë kujdes në vijimësi, për përditësimin e Formularit të Njoftimit, pranë Zyrës së Komisionerit.
5. Detyrimet e parashikuara në pikat 1-3, të reflektuara në procesverbalin e kontrollit administrativ dhe pjesën arsyetuese të këtij Rekomandimi, të plotësohen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e njoftimit të këtij Rekomandimi.
6. Detyrimi i parashikuar në pikën 4, të realizohet brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh, nga data e njoftimit të këtij Rekomandimi.

7. Në zbatim të nenit 32/1 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, me plotësimin e detyrimeve (pika 1-4) të njoftohet me shkrim, pranë Zyrës së Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
8. Me kalimin e këtij afati, në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

**BESNIK DERVISHI**

